



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E HETIMIT SEKTORIAL DHE SIGURISË SË TË DHËNAVE

Nr.1610/11 prot.

Tiranë, më 10.11.2023

REKOMANDIM

Nr. 39, datë 10.11.2023

PËR KONTROLLUESIN “TIRANA INTERNATIONAL SCHOOL”

Në mbështetje të neneve 29, 30, 31 dhe 32 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar (në vijim, “Ligji”), neneve 77-112 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” (në vijim, “Kodi i Procedurave Administrative”), si dhe provave të administruara në ngarkim të kontrolluesit “Tirana International School” (në vijim, “Kontrolluesi”),

KONSTATOVA SE:

Në zbatim të Urdhrit nr. 165, datë 06.10.2023 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim, “Komisioneri”), u krye hetimi administrativ pranë Kontrolluesit, me objekt:

- Zbatimi i ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar, me fokus të veçantë publikimin/informimin/njoftimin/marketingun dhe sigurinë e të dhënave personale, gjatë kryerjes së aktivitetit nga kontrolluesi.

Komisioneri, pasi shqyrtoi relacionin e hetimit administrativ, procesverbalin e konstatimit dhe provat e administruara gjatë ushtrimit të hetimit pranë Kontrolluesit, vëren se:

1. Kontrolluesi është i regjistruar me Vendim nr. 785/12, datë 18.04.2023, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, në regjistrin e OJF-ve, me NUIS K32326006U dhe ushtron aktivitet si institucion arsimor privat parauniversitar, shkollë ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë. Kontrolluesi ushtron veprimtarinë, në zbatim të ligjit nr. 8788, datë 07.05.2001 “Për organizatat jofitimprurëse”, i ndryshuar dhe ligjit nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar”, i ndryshuar. Në kuadër të veprimtarisë që kryen, Kontrolluesi përpunon të dhëna personale për kategoritë e

subjekteve “*nxënës*”, “*prindër*”, “*punonjës*”, “*vizitorë*”, etj. Përpunimi i të dhënave kryhet në mënyrë manuale dhe elektronike.

2. Kontrolluesi disponon një llogari në rrjetin social “*instagram*”, në të cilin publikon fotografi dhe video të aktiviteteve të ndryshme, ku pjesëmarrës janë nxënësit dhe mësuesit e shkollës. Rezulton se, Kontrolluesi ka formularë aprovimi deklarativë për prindërit dhe stafin, nëpërmjet të cilëve shprehet dakordësia për publikimin e fotografive në rrjete sociale dhe aksesin në sistemet e brendshme kompjuterike, etj., përmes politikave të mëposhtme:
- *Student General – Privacy Notice and consent form;*
 - *Student Photos – Privacy Notice and consent form;*
 - *Staff General - Privacy Notice and consent form;*
 - *Staff Photos - Privacy Notice and consent form.*

Kontrolluesi, nëpërmjet këtyre formularëve deklarativë, ka të parashikuara në rubrika të veçanta, dispozita informuese për subjektet e të dhënave, lidhur me qëllimin, mënyrën e përpunimit të të dhënave personale, personin që do t'i përpunojë të dhënat, afatin e mbajtjes së të dhënave, masat e sigurisë, të drejtat që subjektet e të dhënave gëzojnë, etj., lidhur me ushtrimin e të drejtave të tyre, sipas parashikimeve të Rregullores së Përgjithshme për Mbrojtjen e të Dhënave Personale (GDPR). Megjithatë, rezulton se i gjithë dokumentacioni i përgatitur nga Kontrolluesi, në kuadër të informimit të subjekteve të të dhënave, është në gjuhë të huaj (anglisht).

Zyra e Komisionerit vlerëson se, meqenëse Kontrolluesi ushtron veprimtarinë e tij brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, informimi nëpërmjet politikave të privatësisë apo formularëve të pëlqimit, duhet të jetë edhe në gjuhën shqipe sipas të gjitha të drejtave dhe detyrimeve që burojnë nga legjislacioni shqiptar. Informimi i subjekteve të të dhënave personale është një nga detyrimet bazë të Kontrolluesit, pasi u jep mundësinë atyre të njihen me të drejtat që gëzojnë, si dhe mundësinë e ushtrimit të tyre në praktikë. Kontrolluesi duhet të informojë subjektet e të dhënave për fushën dhe qëllimin, për të cilin do të përpunohen të dhënat personale, mënyrën e përpunimit, të drejtën për akses, të drejtën për korrigjim të të dhënave në gjuhën shqipe, në përputhje me parashikimet e nenit 18, të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “*Për mbrojtjen e të dhënave personale*”.

Detyrimi për informim shtrihet përtej njohurive gjuhësore të subjekteve që aksesojnë faqen e internetit të kontrolluesit. Mos përmbushja e këtij detyrimi mund të sjellë pasoja të rënda sa i përket jetës private dhe bashkë me të, të drejtës së subjekteve të të dhënave për mbrojtjen e të dhënave personale të tyre.

Gjithashtu në formularët tip (në gjuhën angleze) depozituar në cilësinë e provës materiale, rezulton që kur kontrolluesi informon për afatin e ruajtjes, nuk përcaktohet një afat konkret lidhur me afatin se sa do të mbahen të dhënat, duke cituar vetëm që

ato mbahen për aq kohë sa duhet për përmbushjen e këtij qëllimi. Një parashikim kaq i përgjithshëm, mund të lë hapësirë për abuzim dhe cenim të të drejtave të subjekteve të të dhënave. Për rrjedhojë, këshillohet caktimi i një afati maksimal i ruajtjes së të dhënave personale, që të justifikojë qëllimin për të cilin grumbullohen këto të dhëna.

3. Nga verifikimi i kryer në regjistrin elektronik të subjekteve kontrolluese, si dhe në protokollin e Zyrës së Komisionerit rezultoi se Kontrolluesi nuk ka përmbushur detyrimin për “Njoftim” në zbatim të neneve 21 dhe 22 të Ligjit.

Kontrolluesi pas marrjes në dijeni të urdhrit të hetimit administrativ ka “Njoftuar” mbi përpunimin e të dhënave personale për të cilat është përgjegjës. Megjithatë, konstatohet se “Njoftimi” ka mangësi në deklarin, sa i përket rubrikave të formularit si vijon:

- i. Deklarimi në rubrikën 5 të formularit të njoftimit “*Të dhënat sensitive që përpunohen*”;
- ii. Deklarimi në rubrikën 7 të formularit të njoftimit “*Marrësit e të dhënave personale*”;
- iii. Deklarimi në rubrikën 8 të formularit të njoftimit “*Transferimi ndërkombëtar i të dhënave personale*”.

Konstatimet e mësipërme janë në kundërshtim me parashikimet e neneve 21 dhe 22 të Ligjit. Zyra e Komisionerit vlerëson se detyrimi për “Njoftim” mbi përpunimin e të dhënave personale, sikurse edhe përditësimet e vazhdueshme të gjendjes së përpunimit, sipas parashikimeve të nenit 21 dhe 22 të Ligjit është i rëndësishëm, pasi i jep mundësinë subjekteve të të dhënave që të informohen për përpunimin e të dhënave të tyre, nga ana e Kontrolluesit, si dhe realizimin e detyrimeve ligjore. Kjo i jep mundësi reale subjekteve të të dhënave për të ushtruar të drejtat e tyre, sipas Ligjit.

4. Nga verifikimi i provave të vendosura në dispozicion nga ana e Kontrolluesit, rezulton se bashkëlidhur marrëveshjes “*tip*” për përpunimin e të dhënave personale, konstatohet një listë përpunuesish, me të cilët Kontrolluesi kryen transferim ndërkombëtar të të dhënave personale, konkretisht drejt Maltës dhe SHBA-së.

Në rastin e Maltës, ky shtet është pjesë e vendeve anëtarë të Bashkimit Evropian dhe bën pjesë në listën e shteteve me nivel të mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave personale të përcaktuara në Vendimin nr. 8, datë 31.10.2016 të Komisionerit “*Për përcaktimin e shteteve me nivel të mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave personale*”.

Për sa i përket SHBA-së, Kontrolluesi duhet të nënshkruajë marrëveshje të posaçme për përpunimin e këtyre të dhënave. Zyra e Komisionerit vlerëson se transferimi ndërkombëtar i të dhënave personale në një shtet i cili nuk është pjesë e listës së Vendimit nr.8 /2016 , legjitimohet duke përmbushur kriteret e parashikuara në nenin 8 dhe 9, të Ligjit.

5. Kontrolluesi ka ndërmarrë masa sa i përket trajnimit të punonjësve që kanë akses dhe përpunojnë të dhëna personale. Megjithatë, nga verifikimi i provave të administruara, rezulton se përmbajtja e tyre nuk i referohet legjislacionit shqiptar në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale, në kundërshtim me parashikimet e nenit 27 të Ligjit dhe Udhëzimit nr. 47, datë 14.09.2018 të Komisionerit *“Për përcaktimin e rregullave për ruajtjen e sigurisë së të dhënave personale të përpunuara nga subjektet përpunuese të mëdha”* (në vijim, “Udhëzimi nr. 47”). të Komisionerit.

Sipas përcaktimeve të Kreut IV, të Udhëzimit nr. 47, trajnimet në lidhje me mbrojtjen e të dhënave personale duhet të jenë të vazhdueshme dhe të përshtatura sipas nevojave dhe proceseve të punës të Kontrolluesit dhe legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale, me qëllim ndërgjegjësimin e punonjësve të cilët për shkak të proceseve të punës, janë të ngarkuar për përpunimin e të dhënave personale.

Në përfundim të hetimit administrativ, referuar provave dhe konstatimeve në vend, grupi i hetimit administrativ hartoi procesverbalin përkatës, një kopje e të cilit i është vendosur në dispozicion Kontrolluesit në rrugë postare.

Në respektim të së drejtës për t’u dëgjuar, në zbatim të neneve 87-89 të Kodit të Procedurave Administrative, Kontrolluesi është ftuar të marrë pjesë në seancë dëgjimore, përpara marrjes së vendimit përfundimtar nga ana e Komisionerit.

Përfaqësuesit e Kontrolluesit janë paraqitur në seancën dëgjimore të datës 31.10.2023, të organizuar nga Zyra e Komisionerit dhe kanë deklaruar angazhimin për rikuperimin e shkeljeve të konstatuara gjatë hetimit administrativ të ushtruar, si dhe bashkëpunimin për përbushjen e detyrimeve ligjore në vazhdim.

Në përfundim, Zyra e Komisionerit vlerëson bashkëpunimin e Kontrolluesit me grupin e kontrollit gjatë ushtrimit të hetimit administrativ, si dhe angazhimin e tij për të rikuperuar shkeljet e konstatuara. Plotësimi i këtyre detyrimeve nga ana e Kontrolluesit është mjaft i rëndësishëm pasi garanton përpunimin e ligjshëm, sigurinë e të dhënave personale dhe shmang mundësinë e përhapjes së tyre në mënyrë të paligjshme.

PËR KËTO ARSYE:

Në zbatim të neneve 18, 20, 21, 22, 27, 29, 30, 31 (pika 1, germa “a/l”), si dhe 32 të Ligjit,

REKOMANDOJ:

1. Kontrolluesi të marrë masa për zbatimin e detyrimeve sipas parashikimeve të nenit 18 të Ligjit, në lidhje me informimin e subjekteve të të dhënave në gjuhën shqipe, sipas legjislacionit të brendshëm;

2. Kontrolluesi, në zbatim të nenit 21 dhe 22 të Ligjit, të ketë në vëmendje përditësimin e “Njoftimit” në lidhje me ndryshimin e gjendjes së përpunimit të të dhënave personale, për të cilat është përgjegjës;
3. Kontrolluesi të ketë në vëmendje zbatimin e detyrimeve sipas parashikimeve të nenit 8 dhe 9 të Ligjit;
4. Kontrolluesi, me qëllim garantimin e sigurisë së të dhënave personale, duhet të zbatojë detyrimet e përcaktuara në nenin 27 të Ligjit dhe Udhëzimin nr. 47, lidhur me trajnimin e punonjësve që kanë akses dhe përpunojnë të dhëna personale.
5. Në zbatim të pikës 1, të nenit 32 të Ligjit, të përmbushen detyrimet, sipas këtij akti brenda afateve, si vijon:
 - (i) vazhdimisht, detyrimet e përcaktuara në pikat 1, 2 dhe 3 më sipër;
 - (ii) brenda 45 (dyzet e pesë) ditëve, detyrimin e përcaktuar në pikën 4 më sipër.

Afatet e sipërpërmendura fillojnë nga data e marrjes në dijeni të këtij akti;

6. Kontrolluesi të njoftojë Komisionerin për masat e marra;
7. Në rast mospërmbushje të detyrimeve të parashikuara në këtë akt, Komisioneri vepron sipas pikës 2, të nenit 30 dhe nenit 39 të Ligjit, të cilët parashikojnë se në rast shkeljesh serioze, të përsëritura ose të qëllimshme të Ligjit nga një kontrollues ose përpunues, veçanërisht në rastet e përsëritura të moszbatimit të rekomandimeve të tij, Komisioneri vendos sanksione administrative për kundërvajtjet administrative përkatëse dhe e denoncon publikisht ose e raporton çështjen në Kuvend dhe në Këshillin e Ministrave.

Ky Rekomandim u shpall sot, më 10.11.2023.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi